


## Përfaqësuesit e KLSH-së marrin pjesë në seminarin e zhvilluar online “Energjia e Qëndrueshme”

Në datat 7-8 Prill 2020, Grupi i Punës së EUROSAT-t për Auditimet e Mjedisit zhvilloi e-seminarin me temë “Energjia e Qëndrueshme”. Seminari ishte planifikuar të organizohej në Maltë dhe SAI i Maltës të ishte mikpritësi i këtij aktiviteti, por në kuadër të situatës shëndetësore globale nga organizatorët u mor vendimi që ai të zhvillohet online. Në këtë seminar morën pjesë më shumë se 60 pjesëmarrës nga Institucionet Supreme të Auditimit të EUROSAT-t. KLSH u përfaqësua nga z. Bajram Lamaj – Drejtor i Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, znj. Ermira Vojka - Audituese e Lartë, Departamenti i Auditimit të Performancës dhe znj. Eva Kasmi -Audituese e Parë, Departamenti i Auditimit të Performancës.



Qëllimi kryesor i seminarit ishte që, pjesëmarrësit të njiheshin me disa praktika të mira të energjisë së qëndrueshme dhe të ndanin eksperiencat e vendeve dhe SAI-ve të tyre. Në këtë kuadër seminari u fokusua në paraqitjen e prezantimeve nga SAI-t që kishin kryer auditime me fokus çështjet e energjisë dhe në paraqitjen e prezantimeve nga aktorë të tjerë të përfshirë në energjinë e qëndrueshme.

SAI-t që ndanë rezultatet e auditimeve të tyre dhe eksperiencën gjatë kryerjes së këtyre auditimeve ishin SAI i Belgjikës, SAI i Hollandës, SAI i Polonisë dhe Gjykata Evropiane e

Audituesve. Në anën tjetër nga aktorët e tjerë të rëndësishëm në çështjet e energjisë së qëndrueshme u paraqitën prezantime nga:

- Prof. Luciano Mule Stagno, nga Universiteti i Maltës – Instituti për Energjinë e Qëndrueshme, i cili prezantoi mundësitë e Maltës në “Shfrytëzimin e Energjisë Diellore”;
- Drejtori i Divizionit të Sigurisë së Energjisë në Bankën Evropiane të Investimeve z. Sanjoy Rajan prezantoi “Politikat e Kreditimit të Energjisë në BEI për Promovimin e Energjisë së Qëndrueshme”
- Z. Taavi Veskimägi, Kryetar i Bordit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në Estoni, ndau me pjesëmarrësit praktikën e Estonisë lidhur me “Rrjetet e Shpërndarjes së Energjisë dhe Tregun e Hapur”.

Në përfundim të seminarit pjesëmarrësit hodhën idenë dhe votuan për mundësinë e kryerjes së auditimeve të përbashkëta me fokus çështjet e energjisë, ku SAI i Hollandës mori përsipër të jetë drejtuesi i këtij projekti në të ardhmen.